



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	04.06.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-93872/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	OJQ – Fondacioni terre des hommes
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoria së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit.
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokolli 07-353/04-93872/21 nga OJQ – Fondacioni terre des hommes me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike, Sheshi “Skënderbeu” me datë 11 Qershor 2021 nga ora 10:00 deri në 17:00. Qëllimi i kërkesës është shënimi i Ditës Ndërkombëtare Kundër Punës së Fëmijëve

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Skënderbeu” me datë 11 Qershor 2021 nga ora 10:00 deri në 17:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

10.06.2021

Faqe 1 nga 1